

V E N D I M
Nr. 154, datë 25.4.2002

**PËR TË DREJTAT DHE DETYRAT E INSPEKTORATIT TË KONTROLLIT SHTETËROR
TË FARËRAVE DHE FIDANËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "dh" të nenit 11 të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës, bimor", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve funksionon pranë Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve dhe përbëhet nga kryeinspektori dhe inspektorët, numri i të cilëve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve ka të drejtë:

a) të ushtrojë kontroll në të gjitha objektet dhe personat, fizikë e juridikë, vendas dhe të huaj, që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për krijimin, riprodhimin, shumëzimin, përpunimin, transportimin dhe tregtimin e materialit mbjellës, bimor;

b) të pajisë me librezë kontrolli nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, inspektorët e Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve dhe personat e tjerë të autorizuar për këtë qëllim. Modeli i librezës përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve ka për detyrë:

a) zbatimin e standardeve shqiptare dhe/ose të specifikimeve teknike për farat dhe fidanët, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit;

b) respektimin e kushteve të domosdoshme agroteknike në ngastrat e prodhimit, të riprodhimit dhe të shumëzimit të farërave e fidanëve, të cilat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të bujqësisë dhe Ushqimit;

c) respektimin e rregullave të transportit, ruajtjes, përpunimit, ambalazhimit, etiketimit dhe tregtimit të materialit mbjellës, bimor;

ç) mbajtjen e dokumentacionit të domosdoshëm teknik, në të gjitha hallkat e riprodhimit, shumëzimit dhe të tregtimit të materialit mbjellës, bimor, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit;

d) respektimin dhe kontrollin e kryerjes së procedurave të certifikimit të materialit mbjellës, bimor, të prodhuar në vend, si dhe verifikimin e dokumentacionit të certifikimit për materialin mbjellës, bimor, të importuar;

dh) lëshimin e certifikatës së garancisë si dokument që vërteton konformitetin e cilësive të materialit mbjellës, bimor në mbështetje të dokumentacionit shoqërues, kur e ka atë, i cili vërteton kryerjen e procedurave të certifikimit;

e) zbatimin e kriterëve të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit për kryerjen e analizave laboratorike të materialit mbjellës, bimor.

4. Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve, për zbatimin e masave administrative dhe për kryerjen e detyrës, bashkërendon punën me organet e policisë së shtetit dhe me organet tatimore e financiare.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko